



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA**

C-II.-19-0017-C0001

Paditësi:

F.B., Mitrovicë

kundër

E paditura:

NSH, në Mitrovicë me të cilën ka administruar *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 9 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi këtë lëndë.
2. Lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 28 korrik 2005 Paditësi F.B. ka parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë për pagimin e tetë muajve 2005-2006 të ndërprerjes së pagesës së pensionit të përkohshëm. Shuma e cila kërkohet në kërkesëpadi është 400 euro.

Më 4 shkurt 2008, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin C.nr.498/06, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike.

Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda i dërgohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë me kompetencë lëndore për vendosjen e kësaj çështjeje kontestimore.

Më 17 janar 2019 Gjykata Themelore në Mitrovicë merr aktvendim për afishim në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate ngase sipas fletkthesës së gjykatës konstatohet se paditësi F.B. nuk është gjetur në adresën e dhënë, dera ka qenë e mbyllur dhe i njëjti është shpërngulur në Suedi.

Më 27 shkurt 2019, Dhoma e Posaçme ka pranuar shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore në Mitrovicë (lënda me numër C.nr.498/06 në DHPGJS e merr numrin C-II.-19-0017-C0001).

Më 15 prill 2019 AKP-ja paraqet mbrojtjen e saj në përgjigje të urdhrin të gjykatës të dërguar më 26 mars 2019 për t'u deklaruar dhe paraqitur argumentet ndaj kërkesëpadisë së paditësit.

AKP-ja në mbrojtje thekson se ka mungesë të legjitimitetit pasiv ngase NSH-ja në fjalë nuk është në juridiksionin e saj dhe kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë propozimin e paditësit ndërsa lëndën ta delegojë te Gjykata Themelore kompetente.

Si provë AKP-ja ka bashkëngjitur Statutin për SH.A. . dhe Ligjin nr. 05/L-120.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi Ligjor:

Për shkak të Ligjit të miratuar më 8 tetor 2012 për Trepçën nr. 05/L-120 (Gazeta Zyrtare nr. 36 e datës 31 tetor 2016), Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ka juridiksion mbi këtë lëndë.

Lënda duhet të dërgohet tek Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Për arsytet e lartcekura gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____